


Përgatitur nga:



# **TESTI I NVM-VE**

Përvoja nga BE-ja,  
Ballkani Perëndimor dhe Holanda



Autorë:

***Erik Akse***  
***Peter Sevat***  
***Jona Jaha***

Dizajn nga:  
***Spontan Creative Media***



***E drejta e autorit © [Dhjetor 2023] Impact Assessment Institute. Të gjitha të drejtat të rezervuara.***

Ky publikim është prodhim i Impact Assessment Institute. Ai synon të sigurojë informacion të detajuar në lidhje me testin e NVM-ve. Informacioni i përfshirë këtu nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin apo këndvështrimin e institucioneve të referuara në këtë dokument. Ju lejohet ta kopjoni, shpërndani, transmetoni dhe përshtatni këtë punim, edhe për qëllime komerciale, me kushtin që ta atribuoni atë me deklaratën: "Ky botim është përgatitur nga "Impact Assessment Institute".

***Shpjegim i përkthimit:***

Versioni origjinal i këtij publikimi është në gjuhën angleze. Versioni i këtij publikimi në gjuhën përkatëse është përkthim nga versioni origjinal në anglisht.



# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1</b>	HYRJE	<b>06</b>
<b>2</b>	TESTI I NVM-VE I KOMISIONIT EVROPIAN	<b>07</b>
<b>3</b>	TESTI I NVM-VE NË BALLKANIN PERËNDIMOR	<b>10</b>
<b>4</b>	TESTI HOLANDEZ I NVM-VE	<b>12</b>
<b>4.1</b>	QËLLIMI DHE SYNIMI I TESTIT TË NVM-VE	<b>12</b>
<b>4.2</b>	TESTI I NVM-VE NË PRAKTIKË	<b>13</b>
<b>4.3</b>	REZULTATET DHE VLERËSIMI I TESTIT HOLANDEZ TË NMV-VE	<b>15</b>
<b>5</b>	MËSIMET E NXJERRA NGA ZBATIMI I TESTIT TË NVM-VE	<b>18</b>
<b>5.1</b>	TESTI I NVM-VE	<b>19</b>
<b>5.2</b>	DALLIMET NË DIZAJN: TESTI I BE-SË KUNDREJT TESTIT TË HOLANDËS PËR NVM-TË	<b>20</b>
<b>5.3</b>	ZHVILLIMI I NJË TESTI EFEKTIV PËR NVM-TË	<b>21</b>
<b>6</b>	REKOMANDIME	<b>24</b>
<b>7</b>	REFERENCAT	<b>26</b>

# 1

## HYRJE

Megjithëse legjislacioni i Bashkimit Evropian (BE) dhe ai kombëtar është krijuar për të sjellë avantazhe për shoqërinë dhe bizneset, sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) në BE shpesh e konsiderojnë këtë legjislacion si shumë kërkues dhe tepër të kushtueshëm për t'u zbatuar. NVM-të e BE-së shpesh i shohin pengesat rregullatore dhe ngarkesat administrative si shqetësimin e tyre kryesor. Reduktimi i sfidave për NVM-të është thelbësor, sepse ato shpesh e ndajnë ndikimin e rregulloreve më shumë sesa kompanitë e mëdha. NVM-të përballen me kosto më të larta fikse, kanë probleme të aksesojnë kapital të përballueshëm dhe janë të ekspozuara ndaj praktikave të padrejta të biznesit për shkak të kompetencës së pabarabartë negociuese me korporatat më të mëdha (Komisioni Evropian, 2021).

Ligjet e thjeshtuara, rregulloret administrative dhe proceset iu ofrojnë NVM-ve avantazhe të rëndësishme në adresimin e sfidave rregullatore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe avancimin e objektivave të politikave në nivel BE-je. Duke qenë se gjatë transpozimit të rregulloreve të BE-së, organet qeverisëse kombëtare, lokale dhe rajonale mund të paraqesin kërkesa legjislative që rezultojnë sfiduese për NVM-të, është e këshillueshme që shtetet anëtare aktuale të Bashkimit Evropian dhe ato që do të jenë pjesë e saj në të ardhmen të krijojnë një praktikë zakonore për aplikimin e metodologjive të tyre për vlerësimin dhe përcaktimin sasior të efekteve mbi NVM-të. Gjatë Vlerësimeve të Ndikimit, vlerësimi i ndikimeve të NVM-ve duhet të fokusohet kryesisht në faktin nëse NVM-të mbajnë një barrë të rëndë dhe vështirësi të tjera në mënyrë disproporcionale në krahasim me korporatat më të mëdha. Nëse ekzistojnë pabarazi të tilla, vlerësimi duhet të shqyrtojë qasje alternative ose fleksibilitetin që mund t'i ndihmojnë NVM-të në arritjen e pajtueshmërisë (Komisioni Evropian, 2021).



# 2

## TESTI I NVM-VE I KOMISIONIT EVROPIAN

Vlerësimi i Ndikimit (VN) luan një rol sistematik në drejtimin dhe forcimin e zhvillimit të politikave të reja ose të ndryshuara. Ai identifikon dhe vlerëson çështjet përkatëse dhe objektivat e synuara, specifikon strategjitë parësore për të arritur këto qëllime dhe shqyrton ndikimet e tyre të pritshme në dimensionet ekonomike, mjedisore dhe sociale. Për më tepër, ai përshkruan kostot dhe avantazhet e lidhura me çdo opsion të politikës që merret në shqyrtim dhe eksploron pasojat e mundshme të paparashikuara, përfitimet sinergjike dhe kompromiset. Përfshirja e Testit të NVM-ve në çdo Vlerësim të Ndikimit rregullator është thelbësor (Komisioni Evropian, 2009). Ky Test synon të formulojë një propozim politikash në mënyrë të tillë që të arrihen qëllimet e tij, duke mos kufizuar ose dëmtuar në mënyrë të paarsyeshme mundësitë për bizneset e vogla (Eurochambres, Business Europe dhe SME United, 2022).

Baza për Testin e NMV-ve qëndron në parimet thelbësore të qasjes "të mendohet pikë së pari për bizneset e vogla" (Komisioni Evropian, 2021), ku theksohet që politikëbërësit duhet të marrin parasysh me shumë kujdes NVM-të gjatë fazave fillestare të zhvillimit të politikave (Komisioni Evropian, 2009). Testi i NVM-ve shërben si hap i domosdoshëm në zhvillimin e iniciativave të politikave të bazuara në prova që arrijnë objektivat e tyre duke reduktuar ngarkesat e tepërta ose të pabarabarta të NVM-ve. Si rrjedhim, përdorimi i saktë i Testit të NVM-ve është i domosdoshëm për krijimin e një kuadri rregullator që mbështet NVM-të dhe, kur zbatohet në mënyrë efektive, mund të çojë në rezultate të suksesshme (Komisioni Evropian, 2021).



Në kuadër të Komisionit Evropian, testi i NVM-ve është një komponent thelbësor i qasjes së Komisionit për vlerësimin e ndikimit që nga viti 2009. Një tipar kyç i testit të NVM-ve përfshin konsultimin direkt me organizatat përfaqësuese të biznesit të vogël ose NVM-të. Testi i NVM-ve parashikon përfshirjen e interesave të NVM-ve në secilën nga fazat analitike të vlerësimit të ndikimit (Komisioni Evropian, 2009). Në thelb, këto faza ndahen kryesisht në katër hapa të ndryshëm:

- 1. Konsultimi me përfaqësuesit e NVM-ve.**
- 2. Vlerësimi paraprak i bizneseve që mund të preken.**
- 3. Matja e ndikimit mbi NVM-të.**
- 4. Vlerësimi i opsioneve alternative dhe masat lehtësuese.**

Vlerësimi i nivelit gjatë të cilit Komisioni Evropian shqyrton nevojat rregullatore të NVM-ve gjatë zhvillimit të propozimeve legjislative mbetet një detyrë sfiduese. Raporti standard i Testit të NVM-ve për vitin 2022, i publikuar bashkërisht nga Eurochambres, Business Europe dhe SME United, shqyrton zbatimin e Testit të NVM-ve në shërbimet e ndryshme të Komisionit Evropian. Qëllimi i standardit është të ofrojë rekomandime për përmirësimin e formulimit të politikave miqësore për NVM-të. Ky raport vlerëson 26 Vlerësime të Ndikimit në përputhje me Udhëzimet për Rregullim më të Mirë të Komisionit Evropian dhe analizon pikëpamjet e Bordit Rregullator të Kontrollit (BRK) për të përcaktuar nëse dhe në çfarë shkalle Testi i NVM-ve, i cili është një komponent i detyrueshëm i procesit të Vlerësimit të Ndikimit, zbatohet me rigorozitet apo jo. (Eurochambres, Business Europe dhe SME United, 2022).

Raporti i Standardit të Testit të NVM-ve thekson se Testit të NVM-ve i mungon konsistenca dhe zbatimi sistematik. Gjetjet kryesore të raportit përfshijnë sa vijon:

- **69% e Vlerësimeve të Ndikimit Fillestar (VNF) për propozimet përfshijnë informacion në lidhje me ndikimin mbi NVM-të.**
- **Në 62% të VN-ve, vërehet një nivel adekuat i angazhimit të palëve të interesuara gjatë konsultimeve, shumica e të cilave përfshijnë konsultime të hapura publike.**
- **Testi i NVM-ve tregon nevojën për diferencim të përmirësuar në vlerësimin e ndikimit në nën-kategori të ndryshme të NVM-ve.**
- **VN-të shpesh nuk arrijnë të marrin në konsideratë masat e nevojshme për zbutjen e sfidave të NVM-të.**
- **Nga 26 konsultimet e detajuara në raportin e VN-së, 10 prej tyre përmbajnë seksione të veçanta që përshkruajnë perspektivat dhe shqetësimet e NVM-ve (Eurochambres, Business Europe, dhe SME United, 2022).**



Duke i njohur këto gjetje, Business Europe, Eurochambres dhe SME United i kërkuan Komisionit Europian që të respektojë në mënyrë të vazhdueshme udhëzimet e testit të NVM-ve (Eurochambres, Business Europe, and SME United, 2022). SME United ka bërë katër rekomandimet e mëposhtme: (1) të rritet planifikimi për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave thelbësore nga organizatat e NVM-ve; (2) t'i kushtohet vëmendje e duhur

efekteve indirekte dhe kumulative NVM-ve; (3) të merren masat që Vlerësimi i Ndikimit të analizojë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha opsionet e politikave, jo vetëm opsionin e preferuar, pasi gati 40% e Vlerësimeve të Ndikimit i kanë shqyrtuar në mënyrë joadekuate implikimet e opsioneve të ndryshme të politikave të NVM-ve; dhe (4) të parashtrohen rezultatet e analizës së ndikimit të NVM-ve brenda një seksioni të veçantë (SME United, 2023).



# 3

## TESTI I NVM-VE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Aktualisht, një pjesë gjithnjë e në rritje e rregulloreve kombëtare në Shtetet Anëtare të BE-së buron nga niveli i BE-së. Një model i krahasueshëm është i dukshëm në vendet kandidate dhe vendet kandidate potenciale, duke përfshirë gjashtë administrata në rajonin e Ballkanit Perëndimor (BP). Nëpërmjet miratimit të Marrëveshjeve të Stabilizim Asociimit (MSA), gjashtë administrata të Ballkanit Perëndimor (BP) kanë marrë përsipër të harmonizojnë legjislacionin e tyre të brendshëm, si ligjet ekzistuese, ashtu edhe ato që do të hartohen në të ardhmen, me *acquis*. Gjatë përpjekjeve për të krijuar një kuadër efektiv për mbikëqyrjen e politikave rregullatore, administratat e BP-së kanë miratuar qasje të tilla si Vlerësimi i Ndikimit Rregullator *ex ante* (VNR), duke intensifikuar përpjekjet e tyre për të reduktuar rreziqet dhe për të arritur rezultate të përmirësuara të politikave rregullatore në mënyrë më të favorshme (SIGMA, 2021).

Udhëzimet dhe metodologjitë e VNR-së të përdorura nga të gjitha administratat e BP-së vendosin zyrtarisht një standard rigoroz për kryerjen e analizave dhe vlerësimin e opsioneve. Ato jo vetëm që e pranojnë shqyrtimin sistematik të llojeve të ndryshme të ndikimit, por

në mënyrë aktive promovojnë atë duke përfshirë konsideratat ekonomike, sociale dhe mjedisore. Këto udhëzime nënvizojnë në mënyrë universale rëndësinë e eksplorimit të qasjeve alternative gjatë procesit analitik (SIGMA, 2021).

Për më tepër, dokumentet udhëzuese të publikuara nga këto administrata theksojnë rëndësinë e metodologjive specifike dhe fushave kryesore për kryerjen e vlerësimeve të ndikimit në përputhje me politikat prioritare. Këto fusha mund të paraqesin mjete për të vlerësuar ndikimet e barazisë gjinore dhe sociale, shqyrtimet e barrës administrative dhe vlerësimet e implikimeve të biznesit dhe NVM-ve.

Udhëzimet dhe metodologjitë e VNR-së autorizojnë kryerjen e analizave ose vlerësimeve të veçanta të ndikimit që përfshijnë, ndër të tjera, ndikimet në konkurrencë dhe NVM-të. Megjithatë, këto udhëzime mbase nuk ofrojnë vazhdimisht udhëzime praktike gjithëpërfshirëse se si të kryhen këto analiza specifike të ndikimit, dhe as nuk përcaktojnë gjithmonë se si të shfrytëzohet ekspertiza dhe burimet e specializuara nga institucionet e tjera përkatëse për të arritur rezultate optimale. Në të njëjtën kohë, rregulloret e krijuara

përfshijnë disa metodologji për kryerjen e Vlerësimeve të specializuara të Ndikimit (SIGMA, 2021).

Në një studim krahasues të kryer nga SIGMA, i cili bazohet në një shqyrtim të rregulloreve dhe metodologjive zyrtare dhe përfshin të dhëna dhe informacione të ofruara nga administratat e BP-së gjatë muajve mars dhe prill të vitit 2020, u vu re se nuk janë shfrytëzuar plotësisht avantazhet e plota të mundshme të VNR-së ex ante në procesin e hartimit të legjislacionit dhe transpozimit të ligjeve të BE-së në BP. Administratat e analizuar në këtë studim përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën (BH), Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë (SIGMA, 2021).

Në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe në Maqedoni të Veriut, detyrimi për

të kryer VNR-në është integruar në Rregulloren e Procedurës (RRP) të secilës qeveri. Në Serbi, kuadri rregullator për zbatimin e VNR-së është më i gjerë dhe reflektohet në akte të ndryshme ligjore, duke përfshirë një ligj të veçantë. Në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës në nivel shtetëror, VNR-ja u fut zyrtarisht përmes një ndryshimi në Rregullat e Përbashkëta për Hartimin Legjislativ (SIGMA, 2021). Midis parametrave të ndryshëm, studimi SIGMA shqyrtoi vlerësimin e ndikimeve të biznesit, veçanërisht në lidhje me NVM-të dhe përdorimin e testit të NVM-ve. Studimi zbuloi se, sipas metodologjive ekzistuese, testi i NVM-ve pritet të përfshihet në VNR në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi. Megjithatë, në vende të tjera si Bosnja dhe Hercegovina (BH), Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, kjo nuk është një kërkesë e detyrueshme (SIGMA, 2021).

Gjatë vlerësimit të 50 kampionëve individualë të VNR-së dhe dokumenteve shoqëruese të tyre të kryer në kuadër të studimit, një vlerësim i cilësisë dhe thellësisë së analizës në lidhje me ndikimin tek bizneset, me fokus të veçantë tek NVM-të, nxori në pah shkallë të ndryshme mbulimi. Konkretisht:

- Vetëm në 4 raste, analiza u vlerësua si gjithëpërfshirëse, duke ofruar një shqyrtim të thelluar të lëndës.
- Në 19 raste, analiza ishte e moderuar, duke ofruar të paktën një nivel njohurish.
- Në 8 raste, mbulimi ishte minimal, duke i kushtuar vetëm vëmendje bazë temës.
- Në 11 raste, analiza ka munguar fare, pa marrë parasysh subjektin edhe pse është vlerësuar relevante.
- Në 8 raste të tjera, analiza u vlerësua ose e pazbatueshme ose jo relevante për kontekstin (SIGMA, 2021).

# 4

## TESTI HOLANDEZ I NVM-VE

Rreth shtatë vjet më parë, Shoqata holandeze e Punëdhënësve për NVM-të (MKB-Holandë) dhe parlamenti holandez pranuan së bashku faktin se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme holandeze (NVM-të) ishin shpesh të ngarkuara nga legjislacioni dhe në shumicën e rasteve këto rezultojnë jopraktike për ta. Pavarësisht ekzistencës së gjatë të parimit "të mendojmë pikësëpari për biznesin e vogël" si pjesë e kornizës legjislative, ndikimi aktual i këtij parimi ishte i kufizuar. Ky shqetësim bëri që parlamenti holandez të miratonte dy mocione në fund të vitit 2016 duke i kërkuar qeverisë të zbatonte një Test të veçantë për NVM-të.

Si përgjigje, Ministria e Çështjeve Ekonomike dhe Politikës Klimatike kreu një studim pilot gjatë periudhës 2017-2018 për të vlerësuar në mënyrë proaktive ex-ante mundësitë për të zbatuar kërkesat e reja ligjore për NVM-të dhe, rrjedhimisht, për të vlerësuar barrën e tyre rregullatore. Kjo nismë pilot përfshiu zbatimin e shtatë Testeve të NVM-ve në ministritë më të rëndësishme legjislative. Pas një vlerësimi gjithëpërfshirës të rezultateve të pilotimit, qeveria holandeze mori vendimin strategjik për shtrirjen e zbatimit të Testit të NVM-ve në të gjithë legjislacionin që do të pasonte, çka pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në

detyrimet rregullatore të NVM-ve, duke hyrë në fuqi që në prill të vitit 2019.

Në vitin 2021, u ndërmor një vlerësim i plotë i testit holandez të NVM-ve, i cili rezultoi kryesisht në rezultate pozitive (MinEZK, 2021).

### 4.1 QËLLIMI DHE SYNIMI I TESTIT TË NVM-VE

Testi holandez i NVM-ve është projektuar për të rritur cilësinë e legjislacionit të ri duke vlerësuar zbatueshmërinë, aftësinë e punës dhe, në mënyrë indirekte, barrën rregullatore që mund të vendosë për NVM-të gjatë fazës së hartimit. Pas konsultimeve me palët kryesore të interesuara, u përcaktua se, në vend të prezantimit të një testi tjetër zyrtar, zbatueshmëria do të vlerësohej përmes konsultimeve të detyrueshme me sipërmarrësit përkatës të MKB-së në takimet e panelit sa më shpejt që të ishte e mundur në procesin e hartimit.

Ky vendim erdhi duke marrë parasysh dy pikëpamje kryesore. Së pari, sistemi legjislativ holandez ka përfshirë tashmë teste dhe procedura të shumta formale, duke përfshirë testin legjislativ, testin e ngarkesave rregullatore, vlerësimet

e zbatimit dhe të zbatimit për degët ekzekutive dhe organet mbikëqyrëse, Testin e Ndikimit të Biznesit (TNB), konsultimet publike të bazuara në internet dhe të tjera, ku të gjitha këto përfshihen në kuadrin e Vlerësimeve të Ndikimit (Integraal Afwegingskader, IAK – rilançar si Beleidskompas). Edhe pse parimi “të mendojmë pikësëpari për biznesin e vogël” u integrua në TNB, jo të gjithë komponentët e IAK-së u zbatuan në mënyrë të vazhdueshme, dhe përveç kësaj mungonte mbikëqyrja efektive e TNB-së.

Për më tepër, këto teste dhe procedura zakonisht ndodhën në fazat e mëvonshme të hartimit të legjislacionit të ri, duke e bërë dukshëm më sfidues paraqitjen e ndryshimeve thelbësore. Në të kundërt, faza e hartimit të hershëm ofroi mundësinë më të mirë për të drejtuar procesin legjislativ në një drejtim tjetër – më miqësor për NVM-të

## 4.2 TESTI I NVM-VE NË PRAKTIKË

Për të siguruar efikasitetin e Testit të NVM-ve, janë krijuar një sërë parimesh dhe rregulloresh nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Çështjeve Ekonomike dhe Politikës Klimatike. Për çdo shqyrtim, kërkohet të mblidhet një panel i ri i përbërë nga sipërmarrës përkatës. Ky panel duhet të përbëhet nga të paktën pesë sipërmarrës që përfaqësojnë NVM-të, të cilët teorikisht duhet të përfaqësojnë specializime të ndryshme dhe firma me madhësi të ndryshme. Përfaqësuesit nga organizatat e industrisë dhe organet mbikëqyrëse nuk janë të ftuar pasi ata mund të japin komente gjatë fazës së mëvonshme të konsultimit publik që do të organizohet nëpërmjet internetit dhe kanaleve të tjera të konsultimit. Ideja është që NVM-të janë në pozicion veçanërisht të mirë – për shkak të përvojës së tyre të përditshme me zbatimin e legjislacionit – për të ofruar komente praktike dhe për të identifikuar sfidat e mundshme të zbatimit.

Udhëzimet për Testin holandez të NVM-ve kërkojnë gjithashtu që ministrinë të vlerësojnë në fillim të procesit të hartimit nëse një Test i NVM-ve është i garantuar. Në raste pasigurie ekziston opsioni i konsultimit me Bordin Këshillimor holandez mbi Barrën Rregullatore, ATR. Të paktën një javë përpara mbledhjes së panelit, NVM-ve duhet t'u dërgohet një fletë koncize faktike ku të ofrohet një shpjegim i drejtpërdrejtë i problemit, objektivave dhe zgjidhjes ligjore të parashikuar nga zyrtarët e politikave.





Qëllimi dhe konfidencialiteti i mbledhjes së panelit, fokusi dhe rregullat e tjera shpjegohen gjithashtu në një aneks përkatës.

Ministria është përgjegjëse për të siguruar një kryetar të pavarur dhe një person për mbajtjen e shënimeve, ku do të jetë i pranishëm edhe zyrtari përgjegjës i politikave për të ofruar sqarime të mëtijshme dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve. Komentet dhe sugjerimet e mbledhura gjatë takimit janë vetëm një pjesë e të dhënave të shumta që i nevojiten zyrtarit në fjalë. Draft raporti i takimit shpërndahet për komente para se të finalizohet. Më pas, shënimet shpjeguese të legjislacionit duhet të përfshijnë një përmbledhje të shkurtër të rezultateve të takimit të panelit dhe mënyrën se si zyrtarët e politikave kanë adresuar komentet dhe sugjerimet kryesore, së bashku me arsyetimin për vendimet e tyre. Shoqata e punëdhënësve dhe organizatat anëtare të industrisë kanë rënë dakord të bashkëpunojnë

në identifikimin e një numri të mjaftueshëm pjesëmarrësish të NVM-ve. Shpeshherë, ky është aspekti që kërkon më shumë kohë për kryerjen e një Testi të NMV-ve. Këto organizata mund të luajnë rol edhe në identifikimin e iniciativave të reja legjislative që mund të ndikojnë ndjeshëm NVM-të. Përveç kësaj, ato japin informacion nëse duhet të organizohet një mbledhje paneli duke dhënë opinionin e tyre mbi nivelin e interesit nga NMV-të. Përvoja ka treguar se mund të jetë zhgënjyese për të gjitha palët e përfshira nëse një mbledhje e panelit anulohet pak para datës së planifikuar për shkak të mungesës së NVM-ve pjesëmarrëse.

Gjatë fazës pilot 2018/2019 janë organizuar takime të paneleve në zyrat e ministrive. Megjithatë, në vitet në vijim, këto takime kaluan në formate online për shkak të pandemisë COVID-19. Ky ndryshim doli i suksesshëm, duke iu kursyer sipërmarrësve të NMV-ve kohën që nevojitej për udhëtim.





### 4.3 REZULTATET DHE VLERËSIMI I TESTIT HOLANDEZ TË NVM-VE

Me fillimin e programit, nga mesi i vitit 2023, janë kryer 54 Teste të NVM-ve në total. Kjo shifër mund të ishte edhe më e lartë nëse nuk do të ishte ndikimi i pandemisë Covid-19 dhe fillimi me vonesë i Testit të NVM-ve nga Departamenti i Thesarit dhe Ministria e Bujqësisë, Natyrës dhe Cilësisë së Ushqimit.

Në vlerësimin e vitit 2021 nga Ministria e Çështjeve Ekonomike dhe Politikës Klimatike, i cili u krye dy vjet pas prezantimit, pyetjet e kërkimit ishin si më poshtë:

*Në çfarë mase është kryer Testi i NVM-ve kur kërkohet dhe në çfarë mase janë dhënë arsyetimet në shënimet shpjeguese për moskryerjen e testit?*

Nga vlerësimi rezultoi se testi është kryer në rreth 80% të rasteve me një ndikim domethënës në

ngarkesat rregullatore, ndërsa në 20% të rasteve nuk është kryer. Arsyetimet për moskryerjen e Testit të NVM-ve janë gjetur vetëm herë pas here në shënimet shpjeguese.

*A ofroi testi i NVM-ve të dhëna me vlerë për zyrtarët e politikave dhe a e kanë marrë seriozisht këtë kontribut gjatë vazhdimit të procesit të hartimit?*

Vlerësimi nxori në pah se zyrtarët e politikave pothuajse gjithmonë i konsideronin të dobishme takimet e panelit, dhe kjo gjetje u konfirmua edhe nga sipërmarrësit e NVM-ve. Testi rezultoi me ndryshime përafërsisht në gjysmën e rasteve të shqyrtuara, ndryshime të reflektuara kryesisht në shënimet shpjeguese të legjislacionit. Deri më sot, ka pasur tre raste (6%) ku nismat legislative ose janë tërhequr ose janë rishqyrtuar si rezultat i testit. Në shumicën e rasteve, shënimet shpjeguese përmbanin një përshkrim të konkluzioneve të mbledhjes së panelit dhe mënyrën se si ato janë adresuar, edhe pse herë pas here janë vërejtur mosveprime.

*Cilat ishin përvojat e të gjitha palëve të përfshira në proces para, gjatë dhe pas takimeve të panelit? Vlerësimi ka treguar disa pika përmirësimi.*

Të kërkuarit e sipërmarrësve të interesuar të NVM-ve shpesh ishte sfidues dhe kjo çoi në rekomandime për përmirësimin e procesit të kërimit nga organizatat e industrisë, duke përfshirë parashikimin e kërkesave për pjesëmarrësit e NVM-ve. Për më tepër, u sugjerua që anëtarët e bordit të organizatave të industrisë, të cilët gjithashtu drejtojnë NVM, të lejohen të marrin pjesë në mbledhjet e panelit për sa kohë që ata flasin nga këndvështrimi i sipërmarrësve.




Për të trajtuar rastet kur zyrtarët e politikave nuk e kuptuan domosdoshmërinë për një Test të NVM-ve ose e bënë shumë vonë, raporti i vlerësimit rekomandoi rritjen e ndërgjegjësimit për vetë testin dhe detyrimin për ta kryer atë në raste specifike. Për më tepër, ai sugjeroi përmirësimin e komunikimit në përgjithësi dhe përmirësimin e mjeteve si udhëzimet.

U bë një rekomandim i përgjithshëm për të krijuar një kënd të vogël mbështetës në Ministrinë koordinuese të Çështjeve Ekonomike dhe Politikave Klimatike për t'u ofruar më shumë ndihmë zyrtarëve të politikave dhe organizatave të industrisë në aktivitetet e tyre përpara takimeve të panelit. Megjithatë, kjo nuk duhet të zvogëlojë përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira.

Një rekomandim tjetër propozonte organizimin e takimeve të panelit një vit pas datës së zbatimit të legjislacionit për të vlerësuar nëse janë ngritur çështje gjatë zbatimit. Këto panele duhet të kenë përbërje më të gjera, duke përfshirë përfaqësues nga organet ekzekutive ose mbikëqyrëse dhe organizatat e industrisë.

Së fundi, vlerësimi nxiti një ndryshim në pyetjet standarde të trajtuara gjatë takimeve të panelit. Në mbledhjet e reja të panelit, duhet të ketë një hetim të qartë lidhur me faktin nëse janë të mundshme opsionet më të lehtësuara në krahasim me përmbajtjen e synuar të legjislacionit të ri.





# 5


## MËSIMET E NXJERRA NGA ZBATIMI I TESTIT TË NVM-ve

Një vlerësim gjithëpërfshirës, qoftë i fokusuar në ndikimet e kaluara apo ato të ardhshme, duhet të shqyrtojë nëse NVM-të mbajnë një barrë joproporcionale ose përballen me disavantazhe në krahasim me korporatat më të mëdha. Kur identifikohen mospërputhje të tilla, është e domosdoshme të eksplorojnë metoda alternative ose qasje të adaptueshme që mund të lehtësojnë pajtueshmërinë e NVM-ve kur rivlerësohet nisma e politikave (Eurochambres, 2022).

Procesi i identifikimit të bizneseve të ndikuar ndan elementë të përbashkët në të gjithë BE-në. Përputhja me normat e BE-së në procesin e identifikimit të efekteve të politikave dhe legjislacionit mbi NVM-të është gjithashtu e dukshme në Ballkanin Perëndimor. Procesi i harmonizimit të legjislacionit në BP

me standardet e BE-së po përparon në mënyrë të qëndrueshme. NVM-të punësojnë një pjesë të konsiderueshme të fuqisë punëtore në vendet e BP, duke punësuar zakonisht midis 60% dhe 80% të popullsisë në moshë pune, përqindje kjo që priret të tejkalojë mesataren e BE-së (WB EDIF, n.d.). NVM-të gjithashtu rrezikojnë të veprojnë jashtë sistemit ligjor, gjë që mund t'i atribuohet gjithashtu vështirësive për të kuptuar dhe zbatuar kërkesat ligjore.

Rrjedhimisht, nxitja e konsultimit efektiv, garantimi i sigurisë legjislative për NVM-të dhe rritja e ndërveprimit midis NVM-ve dhe organeve qeveritare janë faktorë thelbësorë për nxitjen e rritjes dhe avancimit holistik të ekonomive të Ballkanit Perëndimor (WB EDIF, n.d.; SIGMA, 2021)




## 5.1 TESTI I NVM-ve

Brenda BE-së, Testi i NVM-ve shërben si një element themelor i kornizës së VNR-s. Ky mjet dallohet në grupin e instrumenteve të menaxhimit rregullator dhe luan një rol kryesor në ofrimin e njohurive kritike për efektet e mundshme të rregulloreve mbi NVM-të për politikë-bërësit. Testi merr në konsideratë karakteristikat unike të NVM-ve dhe vlerëson proporcionalitetin e këtyre ndikimeve. Për më tepër, Testi ndihmon në identifikimin e grupeve përkatëse të palëve të interesuara që mund të preken dhe ndihmon në formulimin e alternativave rregullatore ose jo rregullatore që synojnë arritjen e objektivave të dëshiruara me barrë të reduktuar për NVM-të (Eurochambres, Business Europe dhe SME United, 2022).

Rëndësia e Testit të NVM-ve brenda kornizës së VNR-së bëhet veçanërisht e dukshme kur merret parasysh rëndësia e tij për Ballkanin Perëndimor. Përfitimet e mundshme kryesisht të pashfrytëzuara nga zbatimi ex ante i VNR si pjesë e proceseve vendimmarrëse të qeverisë dhe përafrimi me rregulloret e BE-së janë të një rëndësie të madhe në BP (SIGMA, 2021).

Qeveritë e BP ushqejnë aspirata ambicioze për integrim me Bashkimin Evropian, duke vepruar shpesh në afate të ngushta kohore për të zhvilluar dhe ratifikuar një vëllim të konsiderueshëm masash

të reja rregullatore që synojnë përmbushjen e standardeve të BE-së. Prandaj, zgjerimi i aplikimit të Testit të NVM-ve është imperativ për të gjitha administratat e BP-së, pasi ai luan rol kryesor në të kuptuarit e implikimeve për NVM-të. Ky përmirësim është kritik në uljen e kostove të panevojshme dhe forcimin e aftësisë së ministrive të linjës të administratave të BP-së për të mbrojtur në mënyrë efektive interesat e politikave në nivel të BE-së (SIGMA, 2021).



## 5.2 DALLIMET NË DIZAJN: TESTI I BE-SË KUNDREJT TESTIT TË HOLANDËS PËR NVM-TË

Dizajni i Testit të NVM-ve mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin. Në Holandë, Testi i NVM-ve është pjesë e një formulari të krahasueshëm të analizës VNR. Megjithatë, Testi holandez nuk përfshin segmentimin specifik bazuar në madhësinë e bizneseve, siç përdoret në Testin e BE-së për NVM-të. Holanda përdor një qasje jokonvencionale dhe të këshillueshme për adresimin e problematikave të NVM-ve gjatë fazës së hershme të procesit të zhvillimit rregullator, duke zgjedhur angazhimin e drejtpërdrejtë nëpërmjet konsultimit. Kjo realizohet përmes paneleve të diskutimeve ku marrin pjesë NVM-të individuale, sipërmarrësit dhe përfaqësuesit e organizatave të NVM-ve. Në këto dialogje, autoritetet rregullatore bashkëpunojnë ngushtë me palët e interesuara të NVM-ve për të vlerësuar me përpikëri praktikitetin dhe zbatueshmërinë e propozimit legjislativ. Fokusi parësor i këtyre konsultimeve është të kuptojë në mënyrë gjithëpërfshirëse ndikimin e mundshëm mbi NVM-të, veçanërisht në lidhje me barrën rregullatore me të cilën mund të përballen (Jennifer, n.d.).

Dallime të tjera në veçorinë e dizajnit ndërmjet testit të NVM-ve të BE-së dhe atij holandez përfshijnë dallimet në fazën e konsultimit të bazuar në internet,

metodat dhe afatet kohore të mbledhjes së komenteve dhe mekanizmat e mbikëqyrjes. Si fillim, testi holandez i NVM-ve zbatohet gjatë fazave fillestare të procesit të hartimit të legjislacionit dhe bazuar në ide specifike rregullatore. Fokusi parësor është në vlerësimin e mundësive që NVM-të të zbatojnë rregullat në shqyrtim, duke marrë parasysh në mënyrë indirekte barrën e tyre rregullatore. Për shkak të kohës së hershme, arritja e sasisë së saktë të barrëve rregullatore është shpesh sfiduese, duke çuar në mbështetjen në vlerësimet e ekspertëve si qasja më e mundshme. Nga ana tjetër, brenda Bashkimit Evropian, konsultimi nuk i përket vetë projekt propozimit. Në vend të kësaj, ai bëhet gjatë fazës së VN-së përpara hartimit aktual të propozimit duke bërë një vlerësim të detajuar të sfidave të zbatimit dhe barrëve rregullatore më pak efektive (Komisioni Evropian, 2021).

Për më tepër, kur bëhet fjalë për mbledhjen e komenteve, si Komisioni Evropian ashtu edhe Holanda kanë pritshmërinë e një angazhimi të fortë me dhe nga bizneset. Megjithatë, dallimet shfaqen në metodologjitë e përdorura për mbledhjen e komenteve dhe kohëzgjatjen e caktuar për përgjigjet. Në Holandë, është përgjegjësi e kompanive dhe organizatave të biznesit që në mënyrë proaktive të japin komentet e tyre. Në të kundërt, BE-ja në përgjithësi përdor anketat dhe pyetësorët e konsultimit si mjete për të kërkuar të dhëna (Komisioni Evropian, 2021). Për më

tepër, periudha e paraqitjes së komenteve në Holandë në përgjithësi përfshin rreth gjashtë javë, një dallim i dukshëm nga afati kohor i Bashkimit Evropian, i cili shtrihet në një kohëzgjatje prej 12 javësh (Komisioni Evropian, 2021).

Së fundi, ka një ndryshim të dukshëm midis mekanizmave të mbikëqyrjes në fuqi për qasjen e BE-së për NVM-të dhe asaj holandeze. Bashkimi Evropian përfiton nga një sistem gjithëpërfshirës mbikëqyrës i administruar nga Bordi Rregullator i Kontrollit, i cili mbulon të gjitha aspektet e procesit të VNR. Nga ana tjetër, Holanda mbështet një fushë veprimi më të kufizuar të mbikëqyrjes, me komponentë specifike të kornizës së VN-së, veçanërisht ato që lidhen me barrën rregullatore dhe alternativat më pak të rënda, që bien nën kompetencën e mbikëqyrjes. Ky rol mbikëqyrës përfshin vlerësimin e rezultateve të nxjerra nga Testi

Holandez i NVM-ve dhe mbikëqyret kryesisht nga ATR (Bordi Këshillues holandez për Barrën Rregullatore).

Si përfundim, është e qartë se në Holandë, ka një theks të dukshëm në vlerësimin e zbatueshmërisë së rregulloreve të reja ligjore për NVM-të dhe shqyrtimin e efekteve të barrës rregullatore mbi bizneset. Ky theksim i atribuohet kryesisht përfshirjes së hershme të Testit të NVM-ve dhe mbikëqyrjes së kryer nga ATR (Bordi Këshillues holandez mbi Barrën Rregullatore). Nga ana tjetër, qasja e BE-së përfshin ekzaminimin e alternativave dhe përpjekjen për të përcaktuar sasinë e ndikimeve të ndryshme. Natyra dhe kompleksiteti i këtij procesi vendimmarrës të BE-së dhe mungesa e një mekanizmi për të kryer një Test të NVM-ve në një draft të një teksti legjislativ mund të paraqesin sfida në vlerësimin e ndikimit të drejtpërdrejtë të Testeve të NVM-ve në rezultatet përfundimtare legjislative.

## 5.3 ZHVILLIMI I NJË TESTI EFEKTIV PËR NVM-TË

Qëllimi i marrjes në konsideratë të NVM-ve në procesin rregullator nuk është t'u jepet atyre një avantazh në kurriz të llojeve të tjera të biznesit, por më tepër të garantohen rregulla loje të drejta dhe të barabarta. Për të kryer një Test efektiv të NVM-ve, hapi fillestar është krijimi i këtij mjeti të menaxhimit rregullator, duke marrë parasysh praktikat më të mira të vendosura në vlerësimin rregullator duke e përafuar atë me kuadrin rregullator të vendit dhe politikat e NVM-ve (Jennifer, n.d.).

Dizajni i Testit të NVM-ve duhet të përfshijë disa elementë, duke përfshirë në cilën fazë të procesit të vendimmarrjes duhet të ndodhë, angazhimin e hershëm të NVM-ve dhe përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e tij për lloje të ndryshme propozimesh rregullatore (p.sh., ligjet ose rregulloret). Një dizajn i mirëmenduar që merr parasysh kohën, qëllimin dhe zbatueshmërinë e këtij mjeti mund të lehtësojë testimin sistematik dhe të qëndrueshëm nga politikëbërësit në një fazë të mëvonshme (Jennifer, n.d.)





## Zhvillimi i një Testi të NVM-ve duhet të përfshijë veprimet kryesore të mëposhtme:

- **Të inkorporohen herët perspektivat e NVM-ve:** Të përfshihen perspektivat e NVM-ve në procesin e vendimmarrjes që në fillim. Të përcaktohet nëse zgjidhjet që adresojnë çështjen e politikave të identifikuara janë të rëndësishme për NVM-të dhe nëse po, të eksplorojnë qasje alternative për të arritur rezultatet e dëshiruara. Politikëbërësit duhet të angazhohen në mënyrë aktive me një gamë të larmishme të NVM-ve gjatë Testit të NVM-ve.
- **Të përcaktohet fushëveprimi i testit të NVM-ve:** Testi i NVM-ve duhet të zbatohet për një spektër të gjerë çështjesh politikash, propozimesh rregullatore dhe rregullore ekzistuese. Megjithatë, shtrirja e testit duhet të përputhet me ndikimet e pritshme dhe të jetë proporcionale. Testi i NVM-ve duhet të përshtatet me kuadrin rregullator dhe të politikave të NVM-ve të çdo vendi.
- **Të vlerësohet rëndësia e NVM-ve për objektivat e politikave:** Të vlerësohet roli i NVM-ve në arritjen e qëllimeve të politikave në shqyrtim.
- **Të identifikohen dhe vlerësohen kostot, përfitimet dhe ndikimet:** Të shqyrtohen tërësisht kostot, përfitimet dhe pasojat e tjera pas Testit të NVM-ve.
- **Të garantohet transparenca:** Të ruhet transparenca gjatë gjithë procesit të Testit të NVM-ve për të rritur besueshmërinë dhe llogaridhënien e tij.
- **Të krijohen mekanizmat e mbikëqyrjes:** Për të siguruar një shqyrtim gjithëpërfshirës dhe objektiv të të gjitha aspekteve të Testit të NVM-ve, një subjekt ose individ i pavarur duhet ta rishikojë testin. Ky organ ose person rishikues mund të ofrojë opinione mbi cilësinë dhe përmbajtjen e Testit të NVM-ve, duke filluar nga rekomandimet për përmirësimin e rezultateve deri te rishikimet e mundshme. Ata gjithashtu mund të rekomandojnë testimin e ardhshëm ose, në raste ekstreme, ta refuzojnë testin nëse i mungojnë elementet thelbësore.
- **Të përdoren rezultatet e testeve:** Rezultatet e Testit të NVM-ve duhet të informojnë vendimmarrjen dhe të ndikojnë drejtpërdrejt në masat rregullatore përfundimtare.
- **“Të testohet Testi”:** Të vlerësohet rregullisht qëndrueshmëria dhe efektiviteti i Testit të NVM-ve për t'u siguruar që ai vazhdon të përmbushë objektivat e synuara (Jennifer, n.d.).

Kjo analizë gjithëpërfshirëse thekson se ndikimi dhe efektiviteti i Testeve të NVM-ve në ndikimin e rezultateve të politikave bazohet në një rrjet faktorësh të ndërlidhur. Këto përfshijnë përshtatshmërinë e legjislacionit të propozuar për shqyrtim përmes testit, kapacitetin e testit për të vlerësuar tërësisht aspektet përkatëse të rregullores, cilësinë e të dhënave dhe hetimeve themelore, të cilat përfshijnë elementin vendimtar të konsultimeve me palët e interesuara, dhe masën në të cilën Rezultatet e testit janë integruar në mënyrë të menduar dhe kuptimplotë në draftin përfundimtar legjislativ (Asociacioni i Institutit të Politikave të NVM-ve, n.d.).

Duke i trajtuar me vëmendje këto elemente, së bashku me konsiderata të tjera thelbësore, politikë-bërësit mund të hartojnë një Test më efektiv dhe gjithëpërfshirës të NVM-ve. Kjo qasje e zgjeruar garanton që vendimet rregullatore të përputhen me nevojat e ndryshme dhe specifike të NVM-ve, duke nxitur njëkohësisht drejtësinë dhe barazinë brenda mjedisit të biznesit. Duke vepruar kështu, politikëbërësit kontribuojnë në krijimin e një kuadri rregullator që është jo vetëm i favorshëm për rritjen dhe prosperitetin e NVM-ve, por edhe që mbështet parimin themelor të mundësive të barabarta për të gjitha bizneset.



# 6

## REKOMANDIME

Për të përmirësuar vlerësimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, është thelbësore të zbatohen një sërë rekomandimesh që marrin parasysh nevojat specifike të këtij sektori jetik ekonomik. Natyrisht, këto rekomandime duhet të vendosen në kontekstin e procesit të zhvillimit të politikave të vendeve individuale në përputhje me kapacitetet e tyre.

Një hap vendimtar në drejtim të përmirësimit të situatës për NVM-të është krijimi i Testit të NVM-ve si një mjet i dedikuar analitik brenda të gjitha administratave të BP. Duke e bërë Testin e NVM-ve një mjet të veçantë dhe të veçuar, administratat mund të vlerësojnë në mënyrë efektive ndikimin e legjislacionit mbi NVM-të. Kjo garanton që çdo ndryshim rregullator ose vendim i politikave të marrë parasysh sfidat dhe mundësitë unike me të cilat përballen NVM-të, duke promovuar një mjedis më të favorshëm biznesi. Shoqatat e biznesit në BP mund të luajnë një rol kryesor në avokimin për miratimin dhe zbatimin e Testit të NVM-ve. Mbështetja e tyre është kritike për rritjen e ndërgjegjësimit midis politikëbërësve dhe palëve të interesuara për rëndësinë e vlerësimit të ndikimeve legjislative mbi NVM-të. Duke u angazhuar me këto shoqata, ne mund të shfrytëzojmë ekspertizën dhe

ndikimin e tyre kolektiv për të mbrojtur kauzën e NVM-ve dhe për të forcuar miratimin e Testit të NVM-ve.

Për më tepër, institucionet e BE-së duhet të ndërmarrin hapa proaktivë për të përmirësuar zbatimin e Testit të NVM-ve. Për ta arritur këtë, BE-ja duhet të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të sfidave të zbatimit dhe barrëve rregullatore që lidhen me Testin e NVM-ve. Ky vlerësim duhet të bazohet në propozimin rregullator të paraqitur nga Komisioni Evropian. Duke identifikuar dhe trajtuar pengesat për zbatimin efektiv, BE-ja mund të sigurojë që Testi i NVM-ve t'i shërbejë qëllimit të synuar dhe të lehtësojë rritjen e NVM-ve në të gjithë rajonin.

Një aspekt themelor i garantimit të efektivitetit të Testit të NVM-ve është zbatimi sistematik i tij në transpozimin e ligjit të BE-së nga shtetet anëtare aktuale dhe të ardhshme të BE-së. Këto shtete duhet të integrojnë Testin e NVM-ve në proceset e tyre legjislative, duke e bërë atë një pjesë rutinë të ligjbërjes. Duke vepruar kështu, ata mund të harmonizojnë kuadrin e tyre ligjor me nevojat unike të NVM-ve, duke nxitur një mjedis biznesi më mbështetës.


Administratat duhet të garantojnë që një mbikëqyrje e fortë është e përfshirë në procesin e



vendimmarrjes për të kontrolluar nëse është kryer konsultimi me NVM-të dhe nëse janë përdorur rezultatet në procesin e hartimit. Kjo mbikëqyrje potencialisht mund të lidhet me procesin e VNR dhe duhet të synojë një zbatim sistematik të Testit të NVM-ve në të gjithë administratën.

Së fundi, Komisioni Evropian duhet të përdorë Testet kombëtare të NVM-ve si mjete të vlefshme në vlerësimin e Acquis të BE-së. Kjo qasje përputhet me parimin “së pari vlerëso” dhe forcon zbatimin e parimit në kontekstin e NVM-ve. Duke marrë parasysh rezultatet e testeve kombëtare të NVM-ve, Komisioni mund të marrë vendime më të informuara në lidhje me ndryshimet rregullatore dhe të sigurojë që politikat e BE-së janë të favorshme për rritjen dhe suksesin e NVM-ve në të gjithë Bashkimin Evropian.

Si përfundim, zbatimi i këtyre rekomandimeve, të cilat përfshijnë kryerjen e Testit të NVM-ve, mbështetjen e shoqatave të biznesit, vlerësimin e sfidave të zbatimit, aplikimin sistematik të Testit të NVM-ve nga shtetet anëtare dhe përdorimin e testeve kombëtare të NVM-ve në vlerësimin e Acquis të BE-së, do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi legjislativ dhe rregullator më miqësor dhe mbështetës për NVM-të. Kjo, nga ana tjetër, mund të kontribuojë në rritjen dhe prosperitetin e përgjithshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si brenda Bashkimit Evropian dhe në mbarë botën.





## REFERENCAT

Eurochambres, Business Europe dhe SME United. (2022). Raporti i Standardit të Testit të NVM-ve 2022.  
<https://www.eurochambres.eu/publication/sme-test-benchmark/>

Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Ndërmarrjeve dhe Industrisë. (2009). Mendoni së pari për bizneset e vogla – Marrja parasysh e interesave të NVM-ve në politikëbërje, duke përfshirë zbatimin e një 'Testi për NVM-të.' Komisioni Evropian.

Komisioni Evropian. (2021). Identifikimi i ndikimeve në vlerësimet, kontrollet e përshtatshmërisë dhe Vlerësimet e Ndikimit. Në Mjetet më të mira të rregullores. Komisioni Evropian.

Jennifer, S. (n.d.). Testi i NVM-ve: Marrja parasysh e NVM-ve dhe sipërmarrësve gjatë rregullimit.  
<https://www.oecd.org/gov/regulatory-policy/the-sme-test.pdf>

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) (n.d.). Indeksi i politikave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Marrë më 29 tetor 2023, nga  
<https://web-archiv.oecd.org/2016-04-04/69489-smallandmedium-sizedenterprisessmepolicyindex.htm>

Ministerie van Economische Zaken en Klimaat (MinEZK), Evaluatie mkb-toets. 29-10-2021,  
<https://www.rijksoverheid.nl/documenten/rapporten/2021/10/29/evaluatie-mkb-toets>

Vlerësimi i Ndikimit Rregullator dhe transpozimi i ligjit të BE-së në Ballkanin Perëndimor: Një analizë krahasuese e praktikës së vlerësimit ex ante të propozimeve rregullatore dhe transpozimit të ligjit të BE-së (SIGMA Papers 61; SIGMA Papers, Vol. 61). (2021).  
<https://doi.org/10.1787/2cbdb615-en>

Shoqata e Institutit të Politikave të NVM-ve. (a.n.d.). Testi i NVM-ve. Marrë më 25 tetor 2023, nga  
<http://www.e-sme.eu/en/the-sme-test/>

SME United. (2023, Mars). NVM-të kërkojnë testim të plotë të NVM-ve.  
<https://www.smeunited.eu/news/smes-ask-for-thorough-sme-test>

BB EDIF (Instituti i Zhvillimit të Ndërmarrjeve dhe Inovacionit në Ballkanin Perëndimor). (n.d.). Ndërtimi i së ardhmes së NVM-ve në Ballkanin Perëndimor.  
<https://www.eif.org/eib.org/attachments/thematic/wb-edif-building-the-future-of-smes-in-the-western-balkans.pdf>



